

VENDIM
Nr. 707, datë 12.10.2016

**PËR TARIFËN E SHËRBIMIT TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN,
TË OFRUAR NGA BASHKITË E PAJISURA ME STACIONE TË KËTJ SHËRBIMI,
NË TERRITORIN E BASHKIVE QË NUK KANË STACIONE TË SHËRBIMIT TË
MZSH-së**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 53, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Tarifa e shërbimit për shuarjen e zjarreve apo për shpëtimin, në raste aksidentesh dhe fatkeqësish të tjera, ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për orë pune.

2. Lista e bashkive të pajisura me stacione të shërbimit të MZSH-së, të cilat do të ndërhyjnë dhe mbulojnë, përkatësisht, territoret e bashkive që nuk kanë stacione të këtij shërbimi, është sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Për efekt të përlllogaritjes së kostove të shërbimit të ofruar nga shërbimi i MZSH-së të bashkisë, koha e ndërhyrjes llogaritet nga momenti i daljes së personelit të shërbimit të MZSH-së nga stacioni zjarrfikës dhe përfundon me largimin e tij nga vendi i ngjarjes.

4. Shumat e arkëtuara nga bashkitë që kërkojnë ndërhyrje për shuarjen e zjarreve apo në raste aksidentesh e fatkeqësish të tjera, sipas përcaktimeve të pikës 1, të këtij vendimi, derdhen në llogaritë e bashkive që kanë ofruar shërbimin dhe përdoren vetëm për financimin e veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së së bashkisë.

5. Shpenzimet për ndërhyrjet e kryera nga një bashki në një bashki tjetër përballohen nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për shërbimin e MZSH-së.

6. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe kryetarët e bashkive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Niko Peleshi

Lidhja nr. 1

**LISTA E BASHKIVE QË KANË STACIONE ZJARRFIKËSE DHE BASHKITË RESPEKTIVE, QË
NUK KANË STACIONE TË KËTJ SHËRBIMI, TË CILAT DO TË MBULOHEN NË NDERHYRJE,
PËRKATËSISHT, NGA KËTO STACIONE**

Nr.	Bashkitë që kanë stacione të shërbimit të MZSH-së	Bashkitë që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së të cilat duhet të mbuloohen respektivisht me ndërhyrjet operuese
1	Berat	Ura Vajguore
2	Durrës	Shijak
3	Burrel	Klos
4	Elbasan	Belsh, Cërrik
5	Librazhd	Përrenjas
6	Fier	Rrokovec
7	Lushnjë	Divjakë
8	Tiranë	Vorë, Kamzë
9	Kavajë	Rrogozhinë
10	Gjirokastër	Libohovë, Dropull

11	Përmet	Këlcyrë
12	Tepelenë	Memaliaj
13	Korçë	Maliq
14	Pogradec	Pustec
15	Pukë	Vau Dejës
16	Malësi e Madhe	Fushë Arës
17	Vlorë	Selenicë
18	Sarandë	Konispol
19	Delvinë	Finiq